



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancën e 47 të mbajtur me datë 31 mars 2021 morri

VENDIM

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka mekanizma ligjore për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me numër 09-5613/1 me datë 12.12.2019, pas të cilës Komisioni shtetëror e ndërpret veprimin.

Lënda me numër 09-5613 me datë 12.12.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

SQARIM

Lënda me numër 09-5613/1 me datë 12.12.2019 është e formuar në bazë të denoncimit nëpërmjet postës elektronike nga personi, me akuza për parregullsi, gjegjësisht konflikt i interesave dhe nepotizëm gjatë punësimit të personit në SHA, në vendin e punës Koordinator, grupa për PRT, Njësia për TS Personi i përmendur ka qenë bashkëshorte e i cili është anëtar i këshillit pranë Këshillit të Komunës, gjatë së cilës parashtruesi thekson se e ka shfrytëzuar ndikimin e vet nga partia në pushtet që ta punëson bashkëshorten. Më tej, personi ka të mbaruar shkenca politike, sipas njohurive të parashtruesit, gjë që nuk përputhet me kushtet e shpallura nga ana e SHA, si dhe atë se nuk ka përvojë përkatëse.

Me qëllim të vërtetimit të akuzave në denoncim, Komisioni shtetëror ka kërkuar dokumentacionin për punësimin e personit, e punësuar në SHA, grupa për PRT, Njësia për TS, Filiala kopje nga diploma për mbarim të arsimit, dëshmi për përvojë pune dhe nxjerrje nga rregullorja për sistematizim për kushte të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës, nga SHA – Shkup.

Nga dokumentacion i dorëzuar është konstatuar se është e punësuar në SHA – Shkup në kohë të pacaktuar nga 01.12.2020, në vendim e punës – Koordinator, grupa për PRT Njësia për TS, Filiala Para fillimit të procedurës me shpalljen e konkursit publik, pas të cilit është punësuar personi i përmendur, SHA ----- Shkup ka dorëzuar kërkesë nr. 02-5357 me datë 04.10.2019 për marrje të pëlqimit për plotësim të 37 vendeve të punës, kurse për 39 ekzekutorë, deri tek Ministria e finansave. Në këtë kërkesë deri tek Ministria për finansa është i përmendur dhe vendi i punës – Koordinator. Në lidhje me kërkesën nr. 02-5357 me datë 04.10.2019 është marrë pëlqim nr. 18-8380/4 me datë 25.10.2020 nga Ministria e finansave. Pas marrjes së pëlqimit për punësim, SHA – Shkup morri Vendim për nevojë për themelim të marrëdhënjes së punës për vendet konkrete të punës dhe është shpallur Konkurs publik në dy gazeta ditore. Konkursi publik është shpallur në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune dhe nenit 25

nga Statusi i SHA Nė konkursin publik ėshtė theksuar se kandidatėt pėrveç kushteve tė prėgjithshme tė caktuara me ligj, duhet tė plotėsojnė edhe kushte tė veçanta. Pėr vendin konkret tė punės – Koordinator si kushte tė veçanta janė theksuar: shkollim tė lartė ose sipėror profesional, shkall VIII ose VI/180-240 ekts dhe njė vit pėrvojė pune. Nė lidhje me selektimin administartiv ėshtė pėrgaditur Listė e aplikatėve – paraqitje tabelare tė tė gjithė 37 vendeve tė punės, ndėr tė cilėt edhe vendi i punės – Koordinator pėr tė cilėn janė paraqitur dy kandidatė. Mė tej, Drejtori gjeneral formon Komision me Aktvendim nr. me datė 06.11.2019 me detyrė; tė realizohet procedura pėr selektim tė tė gjithė kandidatėve tė paraqitur dhe tė pėrgadis propozim nga 5 persona pėr zgjedhje tė kandidatėve pėr vendet e punės. Komisioni i pėrmendur pėrgaditi raport nr. me datė 19.11.2019 dhe ka dorėzuar propozim pėr zgjedhje nė tė gjitha vendet e punės veçmas, me çka pėr vendin e punės – Koordinator janė dorėzuar dy kandidatė tė cilėt i plotėsojnė kushtet nė pėrputhje me gjendjen faktike tė vėrtetuar, dhe Nė bazė tė raportit tė sipėrpėrmendur, Drejtori gjeneral i SHA morri vendim pėr zgjedhje tė kandidatit nė vendin e punės Koordinator, grupa pėr PRT, njėsia pėr TS, Filiala, me tė cilin vendim ėshtė zgjedhur personi

Nė lidhje me akuzat e parashtruesit se personi ka tė kryer shkenca politike, gjė qė nuk pėrputhet me kushtet e publikuara nė konkurs nga ana e SHA, si dhe nuk ka pėrvojė adekuate, nga dokumentacioni i dorėzuar, Komisioni shtetėror vėrtetoi se nė pėrputhje me konkursin e shpallur si kushte qė kėrkohen janė: shkollim profesional tė lartė ose sipėror (duke mos u precizuar lloji i arsimit), shkallė VIII ose VI/180-240 ekts dhe njė vit pėrvojė pune, kandidati i pranuar ka shkollim tė lartė tė fakultetit pėr siguri – Shkup dhe gjithashtu i plotėson kushtet e veçanta pėr pėrvojė pune, gjegjėsisht shihet nga tė dhėnat pėr vėrtetim tė stazhin pensional pėr personin e njėjta ka stazh prej tre vitesh.

Nga ana e Komisionit shtetėror ėshtė kėrkuar dokumentacioni i plotė, mirėpo nga tė dorėzuarat mund tė konstatohet se mungon rang lista me pikėt e fituara tė kandidatėve mė tė mirė para miratimit tė vendimit pėr zgjedhje pas konkursit tė realizuar.

Kėto mangėsi dhe lėshime gjatė realizimit tė procedurės pėr punėsim vetėmse janė konstatuar nga ana e Komisionit shtetėror gjatė veprimit pėr lėndė tjera tė formuara pas akuzave pėr realizim jo tė rregullt dhe joadekuar pėr punėsim dhe janė dhėnė vėrejtje gjatė kryerjes sė kontrollimeve antikorrupsion tė legjislativės tė ligjeve tė caktuar nė fushėn e punėsimit dhe nė Strategjinė nacionale 2021-2025.

Edhe nė kėtė rast gjithashtu edhe nė veprime tė shumėta pas denoncimit pėr akuza tė njėjta ose tė ngjashme nė institucione tjera, Komisioni shtetėror pėr parandalim tė korrupsionit pėrballet me pengesa ligjore dhe pamundėsi pėr ngritje tė iniciativės pėr pėrcaktim tė keqprėdorimit tė funksionit ose iniciativė para organeve tjera kompetente (gjykatave) ose shqiptim i sanksioneve, pėrshkak tė dobėsisve ligjore dhe mungesės sė mekanizmave pėr parandalim tė sjelljeve korruptive.

Duke pasė parasyshė tė shėnuarėn mėsipėr, Komisioni shtetėror pėr parandalim tė korrupsionit vendosi sipas dispozitav.

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР ПЁР
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ
Kryetarё: Biljana Ivanovska

Pas pёrfundimit тё senacёs сё KSHPK
Pёrpunoi: S. M., кёshilltarё
Miratoi: N. B., anёtarё i KSHPK

